- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7, në të cilën është kërkuar: *"Operatoret ekonomik pjesemarres duhet të disponojnë licencë projektimi ose të kontraktojë me kontrate bashkepunimi shoqëri projektuese të licencuara sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".*

*Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:*

***Kat. 2.PROJEKTUES ARKITEKT***

*b-2 qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.*

*d- projektim peizazhi,sistemim siperfaqe te gjelbera,lulishte e parqe.*

***Kat. 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR***

*b- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate*

*d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike*

***Kat. 4. PROJEKTUES INSTALATOR***

*d- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.*

*e- Projektim te instalimeve termoteknike-kondiciionimi , si edhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme .*

*f- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.*

*f- Projektim te sisteme kundra zjarrit.*

*h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).*

*j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV.*

***Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET***

*b- Rilevime Inxhinierike*

***Kat 9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK-HIDROGJEOLOGJIK***

*a) Studim/vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile - ekonomike deri ne 5 kate*

***Kat 12. STUDIME TE SIZMOLOGJISE INXHINIERIKE***

*b) Studim/vleresim gjeologo- sizmike per trojet ku ndertohen objekte civile, sociale e kulturore*

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga ofertuesi ne kete procedure prokurimi rezulton se operatori ekonomik nuk disponon licencë projektimi ose të ketë paraqitur kontrate bashkepunimi me shoqëri projektuese të licencuara sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.11, në të cilën është kërkuar: “Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

***2.3.11/a*** *Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara.*

***2.3.11/b*** *Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit te autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet/materialet sipas pikës 2.3.11***.** *Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.*

***2.3.11/c*** *OE te paraqese një deklarate, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet qe vijne nga prodhimi i tyre.*

*Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyera dhe noterizuara.*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik për pajisjet e kerkuara nuk ka dorezuar ne SPE autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar si dhe nuk ka paraqitur katalogë nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këtë pajisje. Katalogu i pajisjeve është garancia teknike që pajisjet e ofruara janë të përshtatshme, të certifikuara dhe të krahasueshme me përputhshmërinë teknike të kerkuar ne specifikimet teknike.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e cilesise së kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.9, në të cilën është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise” si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike):

| ***STAF TEKNIK*** | ***NUMRI*** |
|---|---|
| *Teknik Ndërtimi* | *1* |
| *Teknik IT/Elektronik* | *1* |
| *Hidraulik* | *2* |
| *Elektricist* | *5* |
| *Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje* | *3* |
| *Hekurkthyes* | *3* |
| *Karpentier* | *5* |
| *Betonues* | *5* |
| *Gurgdhendës/Gurpunues* | *3* |
| *Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)* | *3* |
| *Termoizolues* | *5* |
| *Murator/Suvatues* | *6* |
| *Pllakashtrues* | *4* |
| *Specialist gipsi* | *2* |
| *Punonjes per dyer dritare* | *2* |
| *Shtrues parketi* | *2* |
| *Bojaxhi* | *4* |
| *Specialist veshje fasade* | *5* |
| *Montues ashensori* | *1* |
| *Eskavatorist* | *1* |

| | |
|---|---|
| *Shofer* | *2* |
| *Automakinista* | *1* |

***2.3.9/1*** *Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:*

*a) kontratë individuale të punës;*

*b) leje drejtimi,certifikate e aftesimit profesional (CAP) per shoferet dhe dëshmi aftesimi professional (DAP) per manovratoret-automakinistet/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.*

*(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

***Shënim:*** *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate" ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon stafin teknik sikunder percaktuar ne pikën 2.3.9 te kritereve te vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon:

- 5 (pese) punonjes me profesion *"Betonues"*, ka deklaruar vetem 1 punonjes;
- 5 (pese) punonjes me profesion *"Termoizolues"*, nuk ka deklaruar asnjë punonjës;
- 2 (dy) punonjes me profesion *"Shtrues parketi"*, nuk ka deklaruar asnjë punonjës;
- 4 (kater) punonjes me profesion *"Bojaxhi"*, ka deklaruar 2 punonjes;

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

**5. B.O.E "CURRI"** **J67902718S**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

&

**"XHENGO" sh.p.k** **J64103171M**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***<u>Arsyet e meposhtme:</u>* B.O.E "CURRI" shpk me nr. nipti J67902718S & "XHENGO" sh.p.k**, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisoni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- B.O.E nuk plotëson pikën 2.3.9, në të cilën është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/ akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise" si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike):

| ***STAF TEKNIK*** | ***NUMRI*** |
|---|---|
| *Teknik Ndërtimi* | *1* |
| *Teknik IT/Elektronik* | *1* |
| *Hidraulik* | *2* |
| *Elektricist* | *5* |
| *Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje* | *3* |
| *Hekurkthyes* | *3* |
| *Karpentier* | *5* |
| *Betonues* | *5* |
| *Gurgdhendës/Gurpunues* | *3* |
| *Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)* | *3* |
| *Termoizolues* | *5* |
| *Murator/Suvatues* | *6* |
| *Pllakashtrues* | *4* |
| *Specialist gipsi* | *2* |
| *Punonjes per dyer dritare* | *2* |
| *Shtrues parketi* | *2* |
| *Bojaxhi* | *4* |

| | |
|---|---|
| *Specialist veshje fasade* | *5* |
| *Montues ashensori* | *1* |
| *Eskavatorist* | *1* |
| *Shofer* | *2* |
| *Automakinista* | *1* |

***2.3.9/1** Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:*

*c) kontratë individuale të punës;*

*d) leje drejtimi,certifikate e aftesimit profesional (CAP) per shoferet dhe dëshmi aftesimi professional (DAP) per manovratoret-automakinistet/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.*

*(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate" te dy anetaret e bashkimit te operatoreve ekonomik nuk kane deklaruar asnje punonjes teknik sikunder percaktuar ne pikën 2.3.9 te kritereve te vecanta për kualifikim.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.8, në të cilën është kërkuar: "Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë si staf mbështetës (me kontrate pune/ kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

*- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;*

*- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;*

*- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës*

*Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:*

*Kontratat individuale te punes (të vlefshme)/kontratë bashkëpunimi, Diplomë.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate" per permbushjen e nenpikes per disponimin: "*1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa",* ofertuesit kanë deklaruar konkretisht:

- O.E "CURRI" shpk, ka deklaruar si staf mbështetës punonjesin "A. L" me profesion Audituese Enegjitik, i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;

- OE "XHENGO" sh.p.k, nuk ka deklaruar punonjes me profesion Audituese Enegjitik, i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;

Por nga verifikimi në faqen e internetit të Agjensise per Eficensen e Energjise (*https://eficenca.gov.al/audituesit-dhe-menaxheret/audituesit-e-energjise-ne-ndertesa/*) rezulton se punonjesi "A. L" i deklaruar ne kete procedure prokurimi nuk është i Certifikuar nga ky organ (lista bashkengjitur).

6. O.E "ALBA KONSTRUKSION" shpk J61812013R

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***Arsyet e meposhtme:*** **O.E "ALBA KONSTRUKSION" shpk** me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisoni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 1, shkronjën "a" të kritereve të veçanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit" sipas shtojcës 8, të miratuar me Vendimin nr. 10, date 23.09.2024 "Per miratimin e dokumentave standarde te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit "E hapur-Punë". Per rrjedhoje nuk ploteson edhe kriteret 2.3.3 & 2.3.4 & 2.3.5 & 2.3.6 & 2.3.8 & 2.3.9 & 2.3.10 & 2.3.13 te cilat përmbushen nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

***7. .* B.O.E "EC PRO PARTNERS" shpk** **J67902012U**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

&

**"AD - STAR shpk** **J69102207W**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

***Arsyet e meposhtme:*** **B.O.E "EC PRO PARTNERS" SHPK & "AD-STAR" SH.P.K**, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisoni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- B.O.E nuk plotëson pikën 2.3.8, në të cilën është kërkuar: "Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë si staf mbështetës (me kontrate pune/ kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

*- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;*

*- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;*

*- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës*

*Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:*

*Kontratat individuale te punes (të vlefshme)/kontratë bashkëpunimi, Diplomë.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate" per permbushjen e nenpikes per disponimin: "*1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa",* ofertuesit kanë deklaruar konkretisht:

- O.E "AD-STAR" shpk, ka deklaruar si staf mbështetës punonjesin "E. M" me profesion Audituese Enegjitik, i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;

- OE "EC PRO PARTNERS" sh.p.k, nuk ka deklaruar punonjes me profesion Audituese Enegjitik, i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;

Por nga verifikimi në faqen e internetit të Agjensise per Eficensen e Energjise (https://eficenca.gov.al/audituesit-dhe-menaxheret/audituesit-e-energjise-ne-ndertesa/) rezulton

se punonjesi “E. M” i deklaruar ne kete procedure prokurimi nuk figuron i Certifikuar nga ky organ (lista bashkengjitur).

- B.O.E, me dokumentacionin ligjor të paraqitur në SPE nuk plotëson kriterin 2.3.11/a të “Kapacitetit teknik” të kritereve te veçanta për kualifikim te percaktuar në DT, në të cilin kërkohet si më poshtë:

***“2.3.11/a** Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara”.*

Për përmbushjen e ketij kriteri ofertuesi ka paraqitur nje deklarat me ane te se ciles deklaron se do te ofertojë pajisjet me specifikimet si me poshtë:

| **Nr.** | **Emërtimi i pajisjes/materialeve** | **Modeli** | **Kompania prodhuese** |
|---|---|---|---|
| 3 | "F.Transformator fuqie T.M. S = 630 KVA / 20/0.4 Kv, tip i I thate, me rezine >" | **BETA TRANSFORMATOR** | **BETA TRANSFORMATOR** |
| 4 | F.Çel linje Hyrje 20KV lcc=20KA ln=690A me celes tre pozicione (COT) hyrje+dalje rezerve, me çeles SF6. Perm. (800 x 2000x1200) > | **EUROPOWER** | **EUROPOWER ENERGY** |
| 17 | Furnizim Pompe qarkulluese binjake 1 stand Prurje: 72000 l/h renie presioni 150 kpa | **DCP-G80-2400T** | **DAB PUMPS SPA © VIA MARCO POLO** |

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se B.O.E per pajisjet e sipercituara nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto paisje/materiale. Kjo sjell mospërputhje thelbësore me kriterin e kualifikimit sepse në mungesë të dokumentit nuk provohet se operatori ekonomik ka të drejtën ligjore/kontraktuale për të tregtuar produktet e prodhuesit.

Autorizimi i prodhuesit është një mjet i rëndësishëm për të garantuar origjinën dhe cilësinë e produktit, përgjegjësinë ligjore, garancinë teknike pasi vetëm distributorët e autorizuar kanë të drejtën ligjore të ofrojnë mbështetje teknike, mirëmbajtje, pjesë këmbimi dhe garanci zyrtare nga prodhuesi. Në mungesë të tij, autoriteti kontraktor rrezikon të marrë produkte jo origjinale, pa garanci dhe me vështirësi në mirëmbajtjen e tyre.

Autoriteti kontraktor duhet të ketë garanci se operatori ekonomik ka të drejtën legjitime për furnizim, bazuar në një zinxhir të qartë furnizimi (prodhues → distributor i autorizuar → operator ekonomik).

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

- B.O.E, Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.13. të kritereve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të cilat janë kërkuar në funksion të realizimit të punimeve të sipërcituara. Referuar këtij kriteri operatori ekonomik nder te tjera duhet te disponoje:

  - *Elektroargano: 1 copë;*
  - *Paisje niveluese për nivelim shtresash: 1 copë;*

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga BOE rezulton se ofertuesit nuk kanë deklaruar se disponojne pajisjet e sipercituara. Bazuar në sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve të ndërtimit, KVO gjykon se ofertuesi nuk disponon dhe nuk ka mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

**8. OE "DION-AL" shpk** **K67917301H**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO X

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Nga llogaritja sipas formules se mesiperme rezulton se oferta e OE "DION-AL" shpk eshte anomalisht e ulët. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Sa më sipër, oferta skualifikohet si ofertë anomalisht e ulët.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **(BOE):** "ULZA" shpk me nr. nipti J67902928O, me adresë: TIRANE Njesia bashkiake nr 5, rruga Zef Jubani, ndertesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019 & "ASI-2A CO" shpk me nr. nipti K53002402C, me adresë: FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej

*199,788,458 (njeqind e nentedhjete e nente milion e shtateqind e tetedhjete e tete mije e katerqind e pesedhjete e tete)* lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra **283,8** është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.